

PKR.nr.9/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetar i trupit gjykues Naser Foniqi, me sekretaren juridike Sevdije Breznica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit B. Rr. , i akuzuar për shkak të veprave penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par. 1, të KPRK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.43/2015, të datës 08.01.2016, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 22.11.2017, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari dhe i akuzuari B.Rr., të njëjtën ditë, me datë 22.11.2017, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. Rr., i biri i N. dhe M., e vajzërisë P., i lindur me datë data e lindjes..., në fshatin G., Komuna Podujevë, tani me banim në P., lagja K. e T., rr. “K. L.”, pa numër, me numër personal *numër perosnal...*, ka të kryer shkollën fillore dhe dy vite të shkollës së mesme, i pa martuar, i pa papunë - i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR**I.**

S e p s e: me datë 09.01.2015, rreth orës 20:20, në P., në rr. “H. D.”, ka poseduar pa autorizim një cigare të mbështjellë me substancë narkotike të llojit marihuanë, ashtu që gjatë kontrollit nga ana e policisë e njëjta i është gjetur dhe sekuestruar,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par. 1, të KPRK.

II.

S e p s e: me datë 09.01.2015, rreth orës 20:20, në P., në rr. “H. D.”, ka mbajtur në posedim në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin, një sprej “Nato”, i cili i është gjetur dhe sekuestruar nga policia,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.
- Prandaj gjykata në bazë të neneve: 41; 45 dhe 73, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit, i shqipton:

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditë, dhe**Dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) €,**

- për veprën penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par. 1, të KPRK, të përshkruar si në pikën 1, të dispozitivit të aktgjykimit dhe

2. Dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) €,

- për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK, të përshkruar si në pikën 2, të dispozitivit të aktgjykimit.
- **Me aplikimin e nenet: 80, par.1; 275, par. 1 dhe 374 par.1, të KPRK, të akuzuarit B. Rr., gjykata i shqipton:**

DËNIM UNIK ME BURGIM DHE ME GJOBË ME KUSHT

- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditë, dhe**
- **Dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) €,**
- **Dënimet si më lart, nuk do të ekzekutohen në afat prej 1 (një) viti, në qoftë se i akuzuari, gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.**
- Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **pesëdhjetë (50) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Të akuzuarit, i konfiskohen një sprej “Nato” dhe një cigare me narkotik, të sekuestruara nga policia.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.43/2015, të datës 08.01.2016, ka akuzuar të pandehurin B. Rr., për shkak të veprave penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par. 1, të KPRK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 22.11.2017, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari B. Rr., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë **për veprat penale për të cilat është akuzuar**, si dhe ka shtuar se ndihet shume keq për këtë që ka ndodhur, se sprejin e ka blerë në mëngjes në treg dhe të njëjtën ditë në mbrëmje në një lokal “T.P.”, policia ia ka gjetur gjatë kontrollit, ndërsa sa i përket cigares-narkotikut, i akuzuari ka thënë se të njëjtën vet ia ka paraqitur policisë, me arsyetim se në atë kohë ai ka përdorur-tymosur atë cigare. Pastaj, i akuzuari ka theksuar se pas këtij rasti nuk ka ndodhur dhe ka premtuar se nuk do të ndodh që të mbaj këso cigare apo armë. Në fund të fjalës së tij, i akuzuari ka kërkuar nga gjykata që nëse e shpall fajtor, atij t’i shqiptoi një dënim sa më të butë dhe të ketë parasysh gjendjen e tij ekonomike, duke shtuar se është i pa punë dhe se ekzistencën e siguron nga ndihma e familjarëve të tij.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit ka thënë se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, për veprat penale të përshkruara si në aktakuzë ngase ky pranim është bërë konform dispozitave të KPPK dhe në përputhshmëri me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit si dhe të njëjtit t’i konfiskohen spreji dhe narkotiku.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar

pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e **veprave penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par. 1, të KPRK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK**, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprë penale të kryer; pendimin e thellë të të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale; intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sinjeritetin e treguar gjatë shqyrtimit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; gjendjen e rëndë ekonomike dhe faktin se i akuzuari me parë nuk ka qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK.

Vendimi që të pandehurit t'i konfiskohen arma dhe cigarja - narkotiku, u mor në bazë të nenit 374, par. 3, të KPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 04.12.2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.9/16, datë 22.11.2017.

Sekretare juridike,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.